



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

RREGULLORJA PËR REGJISTRIM DHE KALIM NË FEDERATËN E BASKETBOLLIT E KOSOVËS

PRISHTINË – KORRIK 2016



Në bazë të nenit 21.1.q të Statutit të Federatës së Basketbollit të Kosovës dhe nenit 2.2.l të rregullores mbi punën e Bordit të Federatës së Basketbollit të Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm: Bordi I FBK-së), Bordi I FBK-së në mbledhjen e vet të dates 29 Gusht 2016 e ka miratuar këtë :

RREGULLORE PËR REGJISTRIM NË FEDERATËN E BASKETBOLLIT E KOSOVËS

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1.

Me këtë Rregullore përcaktohen rregullat dhe procedurat për regjistrim, evidencën e klubeve, regjistrimin e lojtarëve-eve, kalimin e lojtarëve-eve prej ekipi në ekip, afatet kalimtare të lojtarëve-eve , fuzionimi (bashkimi) dhe ndarja e ekipeve, pjesëmarrja e lojtarëve vendorë për ekipe ndërkombëtare, regjistrimi dhe paraqitja e lojtarëve të kthyer nga jashtë, e drejta e paraqitjes së lojtarëve ndërkombëtarë (të huaj) në Republikën e Kosovës, e drejta e pjesëmarrjes së lojtarëve për ekipe në ligat e FBK-së dhe licencimi I trajnerëve të basketbollit.

Neni 2.

Komesari i garave i Federatës së Basketbollit të Kosovës, në pajtim me këtë Rregullore, sipas procedurave të cekura në nenin 1 vendos si organ i shkallës së parë.

II. REGJISTRIMI DHE EVIDENCA E KLUBEVE

Neni 3.

- 3.1. Ekipi I cili shpreh dëshirën që të bëhet anëtar I FBK-së, kërkesën për regjistrim ia paraqet Komesarit të garave (Komisionit për regjistrim);
- 3.2. Ekipi I cili e paraqet kërkesën është e obliguar në kërkesë të cekë këto parashtresa:
 - 3.2.1. Emërtimin e plotë të subjektit, në bazë të aktvendimit të Qendrës regjistruese të Republikës së Kosovës;
 - 3.2.2. Emri nën të cilin ekipi do të garojë në njërin prej ligave të FBK-së;
 - 3.2.3 Selia dhe adres e ekipit për pranimin e postës;
 - 3.2.4 Personi I autorizuar për kontakte;
 - 3.2.5 Adres e postës elektronike dhe telefonit për korespodencë zyrtare;
 - 3.2.6 Llogaria rrjedhëse e subjektit dhe emri I bankës;
 - 3.2.7 Numri I regjistrimit të klubit,
 - 3.2.8 Emrat dhe mbiemrat e Krytarit, Drejtorit dhe Sekretarit si dhe numrat e telefonit;
 - 3.2.9 Kërkesës t`I bashkangjitet Aktvendimin e regjistrimit si subjekt juridik në Qendrën regjistruese të Republikës së Kosovës;
- 3.3. Kërkesa duhet të jetë e firmosur nga personi i autorizuar dhe e vulosur me vulen e Subjektit;
 - 3.3.1 Me paraqitjen e kërkesës për regjistrim në FBK, klubi obligohet që të respektojë Statutin, Rregulloret dhe aktet tjera normative të organeve dhe organizatave të Federatës së Basketbollit të Kosovës, FIBA Europa, FIBA dhe Komitetit Olimpik Ndërkombëtar.
 - 3.3.4 Te gjitha palët janë të obliguara që ndrrimet e shënimeve menjëherë t`I lajmërojnë në FBK, në të kundërtën FBK do të ketë përgjegjësi për pasoja juridike.



Neni 4.

Komesari I garave (komisioni për regjistrim) është I obliguar që në afat prej shtatë(7) ditësh pas pranimit të kompletur të kërkesës për pranim, të shqyrtojë të njëjtën dhe 24 orë para skadimit të marrë venim për regjistrimin e ekipit si anëtar të FBK-së.

Komesari I garave (Komisioni për regjistrim) aktvendimin për regjistrim ia dorëzon ekipit, Borit të FBK-së dhe Sekretarit të përgjithshëm të FBK-së.

Nëse kërkesa për regjistrim nuk I përmban të gjitha parakushtet e cekura në nenin 3.2.1, nuk është I bashkangjitur aktevdimi I regjistrimit në Qendrën regjistruese dhe nuk është firmosur dhe vulosur me vulë, Komesari I garave (Komisioni për regjistrim) 24 orë para skadimit të afatit për paraqitje në garat e FBK-së do të marr aktvendim për refuzimin e kërkesës si e pa rregullt.

Neni 5

5.1 Pas regjistrimit të ekipit në FBK, I njëjti është I obliguar që të kyqet në fillim të garave të edicionit të ri, dhe organi I autorizuar I FBK-së është I obliguar që t`ia mundësojë.

5.2.Nëse ekipi nuk kyqet nga fillimi I edicionit në ndeshjene e pare, Komesari I garave (komisioni për regjistrim) i FBK-së sipas detyrës zyrtare do të marr aktvendim mbi fshirjen e ekipit nga antarësimi në FBK.

Neni 6

6.1.Në rast të ndryshimeve statutare të ekipeve në insitucionet e Republikës së Kosovës, apo në rast të së drejtës për të garuar në nivel të caktuar të garave, si dhe ne rastin e fuzionimit (bashkimit) të dy apo më teper ekipeve , Komesari I garave(komisioni për regjistrim) I FBK-së në kërkesë të ekipeve do të lëshon pëlqimin në formë të shkruar, vetëm atëherë nëse kërkesës I bashkangjiten deklaratat për marrjen e të gjitha të drejtave dhe obligimeve nga ekipet të cilat kërkojnë pëlqimin apo marrëveshjet reciproke se cili ekip do t`I marr mbi sipër të drejtat për garim dhe detyrimet.

6.2 Deklarata dhe marrëveshja e detyrimeve duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga personat e autorizuar të të gjitha ekipeve të cekura në deklaratë apo marrëveshje.

Neni 7

Anëtarësimi I klubeve në FBK pushon me:

1. Pushimin e ekipit si person juridik;
2. Daljen me dëshirë të ekipit nga anëtarësimi në FBK me dorëzimin e deklaratës për çregjistrim nga anëtarësimi;
3. Ndalesën për kryerjen e veprimtarisë nga ana e organit të autorizuar shtetror;
4. Vendimin e Bordit të FBK-së, nëse ekipi vepron në kundërshtim me Statutin dhe aktet normative të FBK-së;
5. Vendimin e Komesarit të Garave apo komisioneve tjera të FBK-së nëse klubi edhe pas një vërrejtjeje të dhënë me shkrim edhe më tej vepron në kundërshtim me Statutin dhe aktet tjera normative të FBK-së;
6. Mos pjesëmarrjen e ekipit në garat e FBK-së në dy edicionet e fundit të garave.

Neni 8

8.1. Ne rast të ekzistimit të një prej shkaqeve të cekura në neni 7 të kësaj Rregulloreje, Komesari I garave, në afat prej 30 ditësh nga dita e ndodhjes së shkakut, , sipas detyrës zyrtare duhet të marr aktvendim për fshirjen e ekipit nga anëtarësimi në FBK.

8.2. Komesari I Garave I FBK, aktvendimin nga pika 8.1 ia dorëzon ekipit, Bordit të FBK-së dhe Sekretarit të Përgjithshëm të FBK-së.

Neni 9

Sekretari I Përgjithshëm nëpërmjet të shërbimit udhëheq regjistrin e ekipeve anëheq regjistrin e ekipeve anëare të FBK-s dhe për çdo ekip udhëheq dosien me dokumentacionin e tërësishëm nga moment I regjistrimit të ekipit.



III. REGJISTRIMI I LOJTARËVE-EVE

Neni 10

Të drejtat dhe obligimet gjatë regjistrimit, kalimit dhe paraqitjes së lojtarëve rregullohet në bazë të këtyre parimeve:

10.2.1 Lojtari-ja zgjedh me dëshirë ekipin për të cilin do të paraqitet;

10.2.2 Marrëdhëniet në mes të lojtarit-ës dhe ekipit rregullohen me Marrëveshjen e lidhur në mes të lojtarit-ës dhe ekipit.

10.2.3 Gjatë nënshkrimit të marrëveshjes në mes të lojtarit-ës dhe ekipit, obligim i ekipit është që ta njoftojë lojtarin me Statutin dhe aktet normative të FBK-së, si dhe me aktet dhe rregulloret e ekipit.

10.2.4 Paraqitja e lojtarëve jashta vendit dhe paraqitja e lojtarëve ndërkombëtar (të huaj)

në garat e FBK-së mund të kufizohet për t' u mbrojtur interesi i basketbollit kosovar;

10.2.5 Të gjitha të drejtat tjera rregullohen me këtë Rregullore dhe aktet e përgjithëshme normative të FBK-së, kurse dispozitat e marrëveshjes nuk guxojnë të jenë në kundërshtim me Këtë Rregullore;

10.2.6 Gjatë regjistrimit të lojtarëve të të gjitha moshave, duhet të dorëzohet certifikata mjeksore e gjendjes shëndetsore të lojtarit, dhe atë dy here në vit, para fillimit të pjesës së parë të edicionit garues dhe para fillimit të pjesës së dytë të garave në të cilin merr pjesë lojtari.

Neni 11

Lojtari me dëshirë e zgjedh ekipin për të cilin do të paraqitet dhe me ekipin e nënshkruan Marrëveshjen në të cilën e shpreh vullnetin e lire për t' u regjistruar dhe paraqit për ekipin, deklaron që do t' i pranojë aktet normative të ekipit, FBK-së, institucionit përkatës shtetror, Fiba Evropa, FIBA dhe Komitetit Olimpik Ndërkombëtar dhe do të zotohet se do të respektojë principet e kodeksit të përgjithshëm sportive.

Neni 12

12.1 Çdo ekip është e obliguar që në afatin e caktuar t' ia dorëzojë Komisarit të Garave (Komisionit për regjistrim) listën e lojtarëve të cilët do të paraqiten për ekip;

12.2 Ekipi i cili dëshiron të regjistroj lojtarin-en ia paraqet kërkesën në formularin e posaçëm Komisarit të Garave (Komisionit për regjistrim);

12.3 Gjatë paraqitjes Ekipi duhet të bashkangjës kërkesës:

12.3.1 PËR REGJISTRIMIN E PARË-LOJTARËT-ET GJER NË MOSHËN 14 VJEÇARE

(I dedikohet lojtarëve të cilët për here të parë regjistrohen në regjistrin e lojtarëve në FBK, dhe regjistrimi i tyre bëhet gjatë tërë vitit):

12.3.1.1 Marrëveshjen për stërvitje dhe paraqitje e lidhur në mes të ekipit dhe prindit (kujestarit) të lojtarit (për lojtarët gjer në moshën 14 vjeçare);

12.3.1.2 Certifikatën mjeksore për kontrollimin e kryer mjeksor të lojtarit të lëshuar nga ana e entit të autorizuar për mjeksinë sportive (jo më të vjetër se një muaj);

12.3.1.3 Fotokopien e pasaportës valide

12.3.1.4 Një fotografi 3 x 2,5 cm jo më të vjetër se një (1) muaj dhe një tjetër e dërguar në mënyrë elektronike te Komisarit të Garave (Komisionit për regjistrim);

12.3.1.5 Dëshminë mbi pagesën e taksës në lartësi të cilën e vendosw Bordi i FBK-së për regjistrim dhe licencim të lojtarit-ës.

12.3.1.6 Deklaratën-pajtimin që FBK mund të bëjë përpunimin e shënimeve personale të lojtarit dhe të shërbehet për nevojat e FBK-së;

12.3.2 PËR REGJISTRIMIN E LOJTARËVE NGA MOSHA 15 VJEÇARE GJER NË MOSHËN 18 VJEÇARE

12.3.2.1 Marrëveshjen për aftësim profesional të lidhur në mes të ekipit dhe prindit (kujdestarit) të lojtarit-ës;

12.3.2.2 Certifikatën mjeksore për kontrollimin e kryer mjeksor të lojtarit të lëshuar nga ana e entit të autorizuar për mjeksinë sportive (jo më të vjetër se një muaj);

12.3.2.3 Fotokopien e pasaportës valide



12.3.2.4 Një fotografi 3 x 2,5 cm jo më të vjetër se tre(3) muaj dhe një tjetër e dërguar në mënyrë elektronike te Komesari I Garave (Komisioni për regjistrim);

12.3.2.5 Dëshmin mbi pagesën e taksës në lartësi të cilën e vendosw Bordi i FBK-sw për regjistrim dhe licencim të lojtarit-ës.

12.3.2.6 Deklaratën-pajtimin që FBK mund të bëjë përpunimin e shënimeve personale të lojtarit dhe të shërbehet për nevoja të FBK-së;

12.3.2.7 Deklarata e nënshkruar me të cilën pranon nënshtrimin të doping kontrollit.

12.3.3. PËR REGJISTRIMIN E LOJTARËVE MBI MOSHËN 18 VJEÇARE

12.3.3.1 Marrëveshjen lidhur në mes të lojtarit-ës dhe ekipit

12.3.3.2 Çertifikatën mjeksore për kontrollimin e kryer mjeksor të lojtarit të lëshuar nga ana e entit të autorizuar për mjeksinë sportive(jo ma të vjetër se tre muaj);

12.3.3.3 Fotokopien e pashaportës valide

12.3.3.4 Një fotografi 3 x 2,5 cm jo më të vjetër se gjashtë(6) muaj dhe një tjetër e dërguar në mënyrë elektronike te Komesari I Garave (Komisioni për regjistrim);

12.3.3.5 Dëshmin mbi pagesën e taksës në lartësi të cilën e vendosw Bordi i FBK-sw për regjistrim dhe licencim të lojtarit-ës.

12.3.3.6 Deklaratën-pajtimin që FBK mund të bëjë përpunimin e shënimeve personale të lojtarit dhe të shërbehet për nevoja të FBK-së;

12.3.3.7 Deklarata e nënshkruar me të cilën pranon të nënshtrohet doping kontrollit.

12.3.4 PËR REGJISTRIMIN E LOJTARËVE TË CILË KALOJNË PREJ EKIPI NË EKIP TJETËR

12.3.4.1 Marrëveshjen e lojtarit-ës me ekipin e mëparshëm afati I së cilës ka skaduar apo pëlqimin mbi ndërprerjen e ndërsjellt të Marrëveshjes me ekipin e mëparshëm apo vendimin e plotëfuqishëm për ndërprerjen e Marrëveshjes të marrur nga Komesari I Garave .

12.3.4.2 Marrëveshjen e lidhur në mes të lojtarit dhe ekipit në të cilin kalon;

12.3.4.3 Çertifikatën mjeksore për kontrollimin e kryer mjeksor të lojtarit të lëshuar nga ana e entit të autorizuar për mjeksinë sportive(jo ma të vjetër se tre muaj);

12.3.4.4 Një fotografi 3 x 2,5 cm jo më të vjetër se gjashtë(6) muaj dhe një tjetër e dërguar në mënyrë elektronike te Komesari I Garave (Komisioni për regjistrim);

12.3.4.5 Dëshmin mbi pagesën e taksës në lartësi të cilën e vendosë Bordi i FBK-sw për regjistrim dhe licencim të lojtarit-ës.

12.3.4.6 Deklaratën-pajtimin që FBK mund të bëjë përpunimin e shënimeve personale të lojtarit dhe të shërbehet për nevoja të FBK-së;

12.3.4.7 Deklarata e nënshkruar me të cilën pranon të nënshtrohet doping kontrollit.

12.3.5 PËR REGJISTRIMIN E LOJTARËVE VENDOR TË CILËT KTHEHEN NGA JASHT

12.3.5.1 Fletëlëshimin-Çertifikatën (LETTER OF CLEARANCE) nga federate e basketbollit në të cilën lojtari është paraqit për here të fundit, gjegjësisht ka qenë I licencuar për paraqitj,

12.3.5.2 Marrëveshjen në mes të lojtarit dhe ekipit në të cilin kalon;

12.3.5.3 Çertifikatën mjeksore për kontrollimin e kryer mjeksor të lojtarit të lëshuar nga ana e entit të autorizuar për mjeksinë sportive(jo ma të vjetër se tre muaj);

12.3.5.4 Një fotografi 3 x 2,5 cm jo më të vjetër se gjashtë(6) muaj dhe një tjetër e dërguar në mënyrë elektronike te Komesari I Garave (Komisioni për regjistrim);

12.3.5.5 Dëshmin mbi pagesën e taksës në lartësi të cilën e vendosw Bordi i FBK-sw për regjistrim dhe licencim të lojtarit-ës.

12.3.5.6 Deklaratën-pajtimin që FBK mund të bëjë përpunimin e shënimeve personale të lojtarit dhe të shërbehet për nevoja të FBK-së;

12.3.5.7 Deklarata e nënshkruar me të cilën pranon të nënshtrohet doping kontrollit.



- 12.3.6.3 Një fotografi 3 x 2,5 cm jo më të vjetër se gjashtë(6) muaj dhe një tjetër e dërguar në mënyrë elektronike te Komesari I Garave (Komisioni për regjistrim);
- 12.3.6.4 Çertifikatën mjeksore për kontrollimin e kryer mjeksor të lojtarit, të lëshuar nga ana e entit të autorizuar mjeksor(jo ma të vjetër se tre muaj);
- 12.3.6.5 Fletëlëshimin-Çertifikatën (LETTER OF CLEARANCE) nga federate e basketbollit në të cilën lojtari është paraqit për herë të fundit;
- 12.3.6.6 Një fotografi 3 x 2,5 cm jo më të vjetër se gjashtë(6) muaj dhe një tjetër e dërguar në mënyrë elektronike te Komesari I Garave (Komisioni për regjistrim);
- 12.3.6.5 Dëshmin mbi pagesën e taksës në lartësi të cilën e vendosw Bordi i FBK-sw për regjistrim dhe licencim të lojtarit-ës.
- 12.3.6.7 Deklaratën-pajtimin që FBK mund të bëjë përpunimin e shënimeve personale të lojtarit dhe të shërbehet për nevojat të FBK-së;
- 12.3.6.9 Deklarata e nënshkruar me të cilën pranon të nënshtrohet doping kontrollit.

12.3.7 PROCEDURA PËR REGJISTRIMIN E LOJTARIT NDËKOMBËTAR(TË HUAJ)

- 12.3.7.1 Çdo ekip e cila ka të drejtë të regjistrojë lojtarë ndërkombëtarë(të huaj), se bashku me kërkesën për regjistrim është i obliguar që të dorëzojë dokumentacionin komplet më së voni 48 orë para ndeshjes kampionale apo të Kupës.
- 12.3.7.2 Procedura për sigurimin e Fletëlëshimit (LoC) bëhet nëpërmjet të federative apo nëpërmjet të FIBA dhe FIBA Evropa në harmoni me rregullat dhe afatet e përcaktuara.
- 12.3.7.3 Lojtari fiton të drejtën për paraqitje në ndeshje pas lëshimit të licences për gara nga ana e FBK-së.

Neni 13

- 13.1. Komesari I Garave I FBK-së është i obliguar që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës në FBK të fillojë procedure e regjistrimit të lojtarëve, dhe të njejtën t'a përfundojë në afat prej 15 ditësh nga dita e fillimit të procedurës përveç të natyrës që nevojitet periudhë më e gjatë.
- 13.2 Nëse dokumentacioni i dorëzuar nuk është komplet apo është kontestues, Komesari I Garave do të marrë vendim mbi refuzimin e kërkesës për regjistrim.
- 13.3 Të gjitha vendimet për lojtarët e regjistruar dhe ata të paregjistruar do të publikohen në faqen zyrtare të FBK-së.
- 13.4. Regjistrimi dhe paraqitja e lojtarit është i lejuar pas vendimit të plotëfuqishëm të Komesarit të Garave (Komisionit për regjistrim).

Neni 14

Komesari I Garave (Komisioni zgjedhor) I FBK-së udhëheq evidence e regjistrimit të lojtarëve këto të dhëna:

1. Numrin rendor të regjistrimit;
2. Data e regjistrimit;
3. Emri dhe mbiemri i lojtarit-ës;
4. Data dhe vendi i lindjes së lojtarit-ës;
5. Numri personal i lojtarit-ës je numri i pasaportës;
6. Adresa dhe vendi i banimit të lojtarit-ës;
7. Emri i ekipit për të cilin regjistrohet lojtari

Neni 15

- 15.1 Për Çdo lojtarë-e të regjistruar, Komesari I garave (Komsioni për regjistrim) lëshon licencën e garave.
- 15.2. Licenca lëshohet në kohëzgjatje të përcaktuar.
- 15.3. Përmbajtjen dhe lartësinë e taksës për lëshimin e licencës e përcakton Bordi I FBK-së.



Neni 16

16.1 Lojtari mund të regjistrohet më së shumti për dy(2) ekipe gjatë një edicioni garues.

16.2 Lojtari-ja I cili nënshkruan marrëveshje me dy apo më tepër ekipe gjatë një afati kalimtar, do t'i nënshtrohet përgjegjësisë disiplinore dhe mbetet anëtar I ekipit me të cilin ka nënshkruar marrëveshjen.

16.3 Lojtari I cili ka marrëveshje valide dhe nënshkruan marrëveshje me ekip tjetër në afatin tjetër kalimtar, do të suspendohet dhe I njejt nuk ka të drejtë paraqitjeje deri sat ë përcaktohet përgjegjësi disiplinore. Lojtari I tillë mbetet anëtar I ekipit me të cilin ka marrëveshje valide, kurse marrëveshja e nënshkruar me ekipin tjetër është e pavlefshme.

IV. MARRËVESHJA

Neni 17

17.1 Të drejtat dhe obligimet reciproke të lojtarit dhe ekipit përcaktohen me Marrëveshje.

17.2 Të gjitha marrëveshjet evidentohen në FBK.

17.3 Marrëveshja duhet të nënshkruhet ne tri (3)kopje prej të cilave secila palë e mban nga një kopje dhe një(1) kopje mbetet në FBK.

17.4 Marrëveshja plotësuese e nënshkruar në mes të lojtarit dhe ekipit të njejt dhe nuk është evidentuar në FBK, e me të cilën marrëveshje apo pjesë të saj është përcaktuar angazhimi në sportin e basketbollit, do të ketë fuqi juridike dhe do të pranohet nga trupat e autorizuara të FBK-së, dhe do të evidentohet me numër të njejt të protokollit si ankes I marrëveshjes paraprake.

LLOJET E MARRËVESHJEVE

Neni 18.

18.1. Lojtari deri në moshën 14 vjeçare është I obliguar që me ekipin të cilin e ka zgjedh për stërvitje dhe paraqitje të nënshkruaj marrëveshjen për stërvitje dhe paraqitje.

18.2. Kjo marrëveshje nënshkruhet gjatë regjistrimit të parë për ekip dhe futjen e të dhënave në evidencën e FBK-së. Marrëveshja është valide dhe nënshkruhet deri kur lojtari I mbush 14 vjet.

18.3 Me këtë marrëveshje përcaktohet e drejta e paraqitjes së lojtarit në ligë si dhe të drejtat dhe obligimet reciproke në mes të lojtarit dhe ekipit.

18.4 Përveç rasteve të cekura në marrëveshje, për lojtarët të cilët me ekipin kanë lidhur marrveshje për stërvitje dhe paraqitje që paguajnë anëtarësi në çdo kohë janë të lire që të shkëpusin marrëveshjen për stërvitje dhe paraqitje me ekip dhe ne afatet e caktuara kalimtare të kalojë në ekipin tjetër pa kompenzim, në bazë të nenit 16.1 të kësaj Rregulloreje.

18.5 Lojtari I cili ka marrëveshje për stërvitje dhe paraqitje(deri ne moshën 14 vjeçare), mund të paraqitet edhe për ekipën me moshë më të madhe për ekipën e njejt, nësa ekipa ka të paraqitur për gara at ekip dhe në harmoni me Propozicionet e garave.

MARRËVESHJA PËR AFTËSIM SPORTIV(14-18 vjet)

18.2.1 Lojtari është I obliguar që marrëveshjen e pare për aftësim sportive ta nënshkruaj me ekipin anëtarë i të cilit është kur ti mbush 14 vjet, për katër vitete e ardhëshme.

18.2.2 Lojtari me moshë më të madhe se 14 vjet, I cili për here të pare nënshkruan marrëveshjen për aftësim sportive me ekip,marrëveshjen e nënshkruan të vlefshme përfundimisht me sezonin kur lojtari I mbush 18 vjet.

18.2.3 Në këtë marrëveshtje medeomos duhet të ceket se lojtari a paguan apo jo anëtarësinë për kohën kur është në ekip me të cilin nënshkruan marrëveshjen për aftësim sportive.

18.2.4 Në në marrëveshje nuk është cekur se lojtari paguan apo nuk paguan anëtarësi, në procedurën e Komesarit të Garave(Komisionit për regjistrim) do të nënkuptohet se lojtari paguan anëtarësi.



MARRËVESHJA E PARË PËR SENIORË

18.3.1 Lojtari është I obliguar që të nënshkruaj marrëveshjen e pare për senior me ekipin anëtarë I të cilit ka

qenë kur I ka mbushur 18 vjet të vlefshme edhe për katër (4) vjet.

18.3.2 Lojtari me moshë më të madhe se 18 vjet, I cili duhet të nënshkruaj marrëveshjen e pare për senior, marrëveshjen e nënshkruan përfundimiisht me sezonin kur lojtari I mbush 22 vjet

MARRËVESHJA PËR SENIORË (më të vjetër se 22 vjet)

18.4.1 Marrëveshja për seniorë lidhet për më së paku një(1) edicion garues, nga muaji shtator deri në muajin qershor.

Neni 19.

Për afatin e marrëveshjes së nënshkruar nuk konsiderohet periudha kohore:

1. Që lojtari është I dënuar më shumë se tre(3) muaj ndalesë loje, nga ana e organeve të FBK-së;
2. Që lojtari është I dënuar më shumë se tre(3) muaj ndalesë loje, nga ane e ekipit dhe e konfirmuar nga ana e organeve të FBK-së;
3. Nëse lojtari është paraqit për ekipin tjetër që nuk është anëtar I FBK-së, pa lejen e ekipit të vet;
4. Vajtja në shkollim jashta shtetit, me pëlqimin e ekipit;
5. Nëse me aktvendim të plotëfuqishëm gjyqsor është I dënuar me burgim më shumë se tre(3) muaj.

NDËRPRERJA(SHKËPUTJA) E MARRËVESHJES

Neni 20.

20.1 Nëse lojtari dhe ekipi nuk I plotësojnë obligimet e përcaktuara me marrëveshje, secili nga ta mund të kërkojë ndërprerjen e marrëveshjes.

20.2 Kërkesa për ndërprerjen e marrëveshjes të cilës duhet bashkangjitur prova të sakta për ndërprerjen e marrëveshjes I dorëzohet Komesari të garave (komisionit për regjistrim) të FBK-së. Së bashku me kërkesën, kërkuesi duhet të dorëzojë edhe dëshminë mbi pagesën e taksës për ndërprerjen e marrëveshjes në shumë prej 100€ për kategoritë e seniorëve-eve dhe 50€ për kategoritë e femrave dhe ato të reja.

20.3 Tek kërkesa për ndërprerjen e marrëveshjes lojtari është I obliguar të dorëzojë dëshminë që një kopje e kërkesës për ndërprerjen e marrëveshjes I është dorëzuar ekipit me të cilin është lidhur marrëveshja.

20.4 Komesari I Garave I FBK-së është I obliguar që në afat prej tri(3) ditësh ta marrë në shqyrtim kërkesën për ndërprerje të marrëveshjes dhe procedure e shqyrtimit duhet t'a kryej brenda afatit prej 15 ditësh, nga marrja e kërkesës në shqyrtim, por nëse kërkon natyra e procedure ky afat mund të zgjas periudhë më të gjatë.

20.5 Komesari I Garave në bazë të provave që disponon me aktvendim mund:

20.5.1 Të pranojë si të arsyeshme kërkesën për ndërprerjen e marrëveshjes; apo

20.5.2 Të refuzojë si të pa bazë kërkesën për ndërprerjen e marrëveshjes.

20.6 Nëse Komesari I Garave i FBK-së përcakton se kërkesa e kërkuarit është jo e rregullt dhe e pakjartë, kërkuarisi e obligon që në afat të shkurt të rregullojë dhe precizojë kërkesën në mënyrë që të mund ta shqyrtojë.

20.7 Nëse kërkesa për ndërprerjen e marrëveshjes nuk është rregulluar dhe precizuar në afatin e dhënë, Komesari I Garave (Komisioni për regjistrim) të njëjtën do ta refuzojë si të parregullt.

20.8 Vendimi I Komesari të Garave (Komisionit për regjistrim) I FBK-së I marru në kërkesë për ndërprerje të marrëveshjes I dorëzohet lojtarit dhe ekipit.



V. KALIMI PREJ EKIPI NË EKIP

Neni 21.

21.1 Lojtari me moshë mbi 18 vjeç(senior) mund të kaloj prej ekipi në ekip vetëm në afate kalimtare të cilat caktohen me vendimin e Bordit të FBK-së .

21.2 Afati I paraqitjes së listës(rosterit) për të gjitha kategoritë e seniorëve përcaktohet me vendimin e Bordit të FBK-së.

21.2 Lojtari prej 14 deri në moshën 18 vjeçare (të rinjtë), mund të kalojë prej ekipi në ekip në afatin kalimtar veror dhe dimëror.

21.2.1 Afati veror për lojtarë caktohet me Vendim të Bordit-it të FBK-së.

21.2.2 Afati dimëror për lojtarë të moshës 14-18 vjeçare zgjatë pesë(5) ditë dhe caktohet me Vendim të Bordit-it të FBK-së.

21.2.3 Afati për dorëzimin e listës së lojtarëve prej moshës 14 deri në moshën 18 vjeçare, konform dispozitave të kapitullit për regjistrimin e lojtarëve caktohet me vendim të Bordit të FBK-së.

21.3 Lojtari deri në moshën 14 vjeçare mund të kalojë prej ekipi në ekip gjatë kohës së afateve kalimtare verore dhe dimërore.

21.3.1 Afati për dorëzimin e listës së lojtarëve deri në moshën 14 vjeçare, konform dispozitave të kapitullit për regjistrimin e lojtarëve caktohet me vendim të Bordit të FBK-së.

Neni 22

22.1. Lojtari I cili ka të lidhur marrëveshjen me ekip, dhe nuk gjindet në listen paraqitëse të ekipit për edicionin e ardhshëm garues, nëse ekipi është përjashtuar nga garat apo ekipi është larguar nga garat për shkaqe të ndryshme, te drejtën për të kaluar prej ekipi në ekip mund t'a realizojë më së voni deri në ditën e përfundimit të afatit të rregullt kalimtar.

22.2. Lojtari I regjistruar për ekip të seniorëve, I cili e ka ndërprer marrëveshjen me ekip, mund të realizojë vetëm një kalim në ekip tjetër, deri ne 24 orë para fillimit të çfardo ndeshjeje të pjesës së pare, gjegjesisht gjer në ditën e fundit të afatit kalimtar dimëror.

22.3 Nuk konsiderohet si kalim prej klubi në klub, nëse lojtari nuk është paraqitur për ekip, për atë që ekipka qenë I përjashtuar, është larguar nga garat, apo për shkaqe të ndryshme nuk I ka filluar garat në edicionin e ri. Në këtë rast, lojtari është I lirë që të nënshkruaj për çfardo ekipi tjetër dhe të realizojë të drejtën të kalojë në ekip tjetër, në harmoni me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

22.4 Nuk konsiderohet kalimi prej klubi në klub, nëse lojtari ka të lidhur marrëveshjen me ekip, dhe nuk gjindet në listen paraqitëse të klubit para fillimit të edicionit të ri garues (për at që marrëveshja në mes të lojtarit dhe ekipit pushon të vlej), nënshkruan marrëveshje me ekipin tjetër për edicionin vijues. Në këtë rast, lojtari është i lire të nënshkruaj marrëveshje me çfardo ekipi tjetër dhe me këtë të realizojë të drejtën për kalim edhe në një ekip, në harmoni me dispozitat e këregulloreje.

22.5 Lojtari nuk mund të paraqitet në të njejtën xhiro për dy ekipe.

22.6 Për lojtarë ndërkombëtar(të huaj) vlejné dispozitat e kapitullit IX të kësaj Rregulloreje.

22.7 Lojtarët e ligave të kategorive të reja të FBK-së, të cilët do të largohen nga listat paraqitëse të ekipit merrin statusin e lojtarit të lire me të drejtë kalimi në ekip tjetër pa dëmshpërblim, në harmoni me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

Neni 23.

23.1 Të drejtë kalimi prej ekipi në ekip ka:

23.1.1 Lojtari të cilit I ka skadue marrëveshja dhe nuk don të në nënshkruaj marrëveshje të re me ekipën e gjertanishme;

23.1.2 Lojtari I cili e ndërpren mëveshje marrëveshjen me ekip;

23.1.3 Lojtari të cilit me aktvendim të plotëfuqishëm të organit të autorizuar të FBK-së I është ndërprer marrëveshje me ekipen e gjertanishme;



23.1.4 Lojtari i cili nuk gjindet ne listën paraqitëse(rosterin) të ekipit për edicionin(sezonën) e ardhëshëm;

23.1.5 Lojtari i ekipit që është përjashtuar nga garat apo I ka lëshuar garat për shkaqe të ndryshme gjatë edicionit actual mund të kalojë prej klubi në klub në afat prej 10 dite nga dita e tërheqies nga garat apo nga dita e përjashtimit të ekipit nga garat e mëtutjeshme.

23.1.6 Lojtari gjer në moshën 14 vjeçare, pa dëmshpërblim, vetëm nëse ajo nuk është rregulluar me marrëveshjen për stërvitje dhe paraqitje;

23.1.7 Lojtari prej moshës 14 deri në moshën 18 vjeçare, I cili ka marrëveshjen për aftësim sportive me ekipin e caktuar, ka të drejt kalimi prej ekipi në ekip në vend, nën këto kushte:

23.1.7.1 Nëse lojtari ka paguar në ekip për aftësimin e tij sportive dhe nëse për këtë dëshmon me dokumentacionin valid, ka të drejtë kalimi në ekipin tjetër në vend, pa dëmshpërblim dhe ate vetëm një here gjatë një edicioni garues.

23.1.7.2 Nëse lojtari nuk I ka paguar ekipit për aftësimin e tij sportive, ka të drejtë kalimi në ekipin tjetër me dëmshpërblim. Nëse me marrëveshje reciproke për aftësim sportive nuk është cekur shuma për dëmshpërblim, atëherë do të paguhet sipas këtyre kriterëve:

1. 1000 Euro, për çdo edicion të paraqitur për ekip(shtator-Qershor) në ligat e grupmoshave të reja;

2. 1000 Euro, për çdo edicion të paraqitur për ekip në ligat e grupmoshave të reja, nëse është I licencuar nga FIBA Evropa për përzgjedhjet e reja të FBK-së, prej të cilës shumë 75% paguhen në llogarinë e klubit dhe 25% në llogarinë e FBK-së. Gjatë llogaritjes së dëmshpërblimit mirret parasysh çdo edicion në të cilin ka qenë lojtari në përzgjedhje.

3. Nëse bëhet fjalë për transfer ndërkombëtar, shumat e lartë përmendura dyfishohen, gjegjesisht shumëzohen me dy(2);

4. Logaritjen e lartësisë së dëmshpërblimit e bënë Komesasri I Garave I FBK-së, Dëmshpërblimi llogaritet për tërë edicionin (gjithësejt 10 muaj). Në rast që lojtari ka paguar anëtarësinë mujore në ekip, dëmshpërblimi llogaritet vetëm për periudhën për të cilën nuk ka dëshmi për pagesë të anëtarësisë, ku shuma e paraparë për kompensim pjestohet për dhjetë(10) muaj dhe shuma e fituar shumëzohet me numrin e muajve për të cilat nuk ka dëshmi për pagesën e anëtarësisë.

5. Nëse lojtari, I cili e ka fituar të drejtën e lojtarit të përzgjedhjes, gjegjesisht është licencuar nga ana e FIBA për ndonjë përzgjedhje, kërkon që të ndërprejë marrëveshjen gjatë rrjedhjes së edicionit të garave, llogaritja e dëmshpërblimit do të bëhet në bazë të alinesë

23.1.7.2/1 dhe 23.1.7.2/2 të nenit 23

Lojtari ka të drejtën e fituar të lojtarit të përzgjedhur të cilën mund ta humb nëse pas përfundimit të edicionit aktual në listen e lojtarëve të licencuar nga FIBA për çfardo përzgjedhje nacionale.

6. Dëshmia për pagesën e kryer për dëmshpërblimin e caktuar dorëzohet në zyren e FBK-së.

7. Ekipi I cili duhet të dëmshpërblehet, mund të heq dorë nga dëmshpërblimi me nënshkrimin dhe vulosjen e deklaratës nga personi I autorizuar I ekipit, dhe e njeta duhet të dorëzohet në zyren e FBK-së.



VI. FUZIONI (BASHKIMI) I EKIPEVE

Neni 24.

24.1 Fuzionimi (bashkimi) I ekipeve në garat e FBK-së është fuzionimi I dy e më tepër ekipeve me marrëveshje për fuzionim në formë të shkruar, për realizimin e intereseve të tyre dhe zhvillimin e sportit të basketbollit.

24.2 Gjatë kërkesës për fuzionim, ekipet janë të obliguara që në afatet e caktuara me këtë nen, t'i dorëzojnë Komesarit të Garave (komisionit për regjistrim) Marrëveshjen origjinale për fuzionim me numër të mjaftuar të kopjeve (nga një për çdo ekip pjesëmarrës në fuzionim dhe një për FBK). Marrëveshja do të evidentohet në regjistrin e FBK-së prej që dëshmohet pagesa e taksës administrative në shumë prej 500€.

24.3. Komesari I Garave (Komisioni për regjistrim) I FBK-së është I obliguar që në afat prej 3 (tri) ditëve nga dita e marrjes së kërkesës të marr lëndën në procedure dhe e njejta duhet të përfundojë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së lëndës në procedure, përveç nëse natyra kërkon periudhë më të gjatë.

24.4. Marrëveshja për fuzionim në mes të dy apo më tepër ekipeve të FBK-së merr efekt ligjor në momentin kur e njejta lejohet me aktvendimin e Komesarit të Garave (komisionit për regjistrim) të FBK-së.

24.5 Nga moment I fuzionimit të lejuar me aktvendimin e Komesarit të Garave (Komisionit për regjistrim), ekipet e fuzionuara fillojnë të realizojnë të drejtat dhe obligimet e tyre në FBK si një ekip, gjegjësisht në harmoni me marrëveshjen reciproke për fuzionim nëpërmjet të përfaqësuesit dhe nënshkruesit të autorizuar zgjedhet emri i ekipit, vula, llogaria bankare në Republikën e Kosovës, kontaktet, selia dhe adresa postare elektronike e ekipit dhe i njejti në të ardhmen do të jetë përfaqësues pranë FBK-së.

24.6. Ekipi, përfaqësues I ekipeve të fuzionuara, në bazë të marrëveshjes për fuzionim, vazhdon të bëjë gara në një nga ligat e seniorëve, gjersa klubet tjera, pjesëmarrës në fuzionim, mund të vazhdojnë veç e veç të garojnë në ligat e grupmohave të reja të FBK-së si subjekte të veçanta ligjore. Ekipet pjesëmarrëse në fuzionim nuk kanë të drejtë të garojnë në ligat e seniorëve gjersa marrëveshja për fuzionim është në fuqi.

24.7 Në marrëveshjen për fuzionim duhet të jetë dispozita për mënyrën e ndarjes eventuale, kun ë mënyrë precise duhet të ceket se cilat nga ekipet dhe me çfarë statusi do të vazhdojnë pas ndarjes së krijuar, përgjegjësia financiare e subjekteve - të ardhurat nga anëtarësia, nga marketing I ligave, dhuratat për plasma në ligat e FBK-së etj, si dhe shpenzimet për gara, kotizizme, dënime, licencime dhe shpenzime tjera në harmoni me Rregullore dhe Propozicione të Garave dhe akteve tjera, si dhe në bazë të vendimeve të trupave të autorizuar të FBK-së.

24.8 Fuzioni I ekipeve mund të ketë veprim ligjor në sistemin e garave të FBK-së nëse kryhet më së voni 24 orë para paraqitjes së listës paraqitëse për garat e FBK-së për edicionin e ardhshëm të garave.

24.9 Fuzionimi i ekipeve pas këtij afati mund të ketë veprim ligjor në sistemin e garave të FBK-së nga edicioni tjetër.

VII. PARAQITJA JASHTA SHITIT

Neni 25

Lojtari fiton të drejtën e paraqitjes jashta vendit pas marrjes së pëlqimit nga ekipi dhe lëshimit të fletëlëshimit (LoC) nga ana e FBK-së

Neni 26

26.1. Kërkesa për dhënie e pëlqimit për paraqitje jashta vendit I dorëzohet Komesarit të Garave (Komisionit për regjistrim) nëpërmjet të zyrës së FBK-së, ku dokumentacioni komplet duhet të përmbajë:

1. Kërkesa nga federata ndërkombëtare të cilës I përket ekipi, e adresuar në FBK;
2. Pëlqimi I ekipit për paraqitje jashta vendit, nëse marrëveshja është valide;
3. Pagesa e taksës administrative për fletëçregjistrim (LoC) .



Neni 27

27.1 Transferi ndërkombëtar I lojtarëve gjer në moshën 18 vjeçare nuk është I lejuar, përveç në raste special ku me pëlqimin e ekipit në formë të shkruar, personi i autorizuar I FBK-së lëshon Fletëlëshimin(LoC) për të luajtur jashta shtetit, në bazë të dispozitave të përcaktuara me aktet e FIBA dhe me këtë Rregullore për regjistrim dhe kalim në FBK;

27.2. Për lojtarët më të bjetës se 18 vjet, LoC për të luajtur jashta vendit e lëshon personi I autorizuar në bazë të dispozitave të përcaktuara me aktet e FIBA dhe me këtë Rregullore për regjistrim dhe kalim në FBK;

27.3. FBK e lëshon LoC me kusht qe lojtari I cili shkon jashta shtetit të nënshkruaj deklaratën se në çdo kohë do të jetë në disponim për ndeshjet dhe përgatitiet e përzgjedhjes së Kosovë.

27.4 Vendimin për të luajtur jashta vendit e merr Komesari I Garave në afat prej shtat(7) ditësh nga dita e pranimit të dokumentacionit komplet, kurse LOC e lëshon Sekretari I Përgjithshëm I FBK-së.

VIII. KTHIMI I LOJTARIT NGA JASHTË

NENI 28.

28.1. Lojtari I cili merr pëlqimin për të luajtur jashta vendit gjatë edicioni actual mund të kthehet dhe të paraqitet në kampionatin vendor me dokumentacionit komplet **më së voni deri në përfundim të afatit kalimtar.**

28.2. Lojtari I cili ka realizuar një transfer gjatë edicionit aktua, e pastaj realizon edhe transfer ndrkombëtar, mund të regjistrohet si lojtar I kthyer nga jasht vetë në ekipin nga I cili ka marr pëlqimin për të luajtur jashta vendit **më së voni deri në përfundim të afatit kalimtar.**

28.2 Lojtari mund të kthehet dhe të paraqitet në kampionatin vendor në ekipin me të cilin nënshkruan marrëveshje, vetëm nëse ka realizuar angazhman në ndonjë ekip jashta vendit dhe nëse ka luajtur në më së paku katër(4) ndeshje kampionale apo të Kupës për ekipin jashta vendit. **Rregjistrimi i lojtarit te kthyer nga jashte eshte i mundur deri 72 orë per ekipet e superliges deri para zhvillimit te xhiros se XXII (ku skadon afati edhe per regjistrimin e lojtareve te huaj),**

IX .PARAQITJA E LOJTARËVE NDËRKOMBËTAR (TË HUAJ)

Neni 29

Lojtar ndërkombëtar (I huaj) nënkuptohet lojtari i cili nuk ka shtetësinë e Republikës së Kosovës.

Neni 30

30.1 Për ndeshjet kampionale dhe të Kupës çdo ekip pjesëmarrëse ka të drejtë të regjistrojë lojtarë ndërkombëtarë (të huaj) për ndeshjet kampionale dhe tx137 Kupës, në bazë të dispozitave të përcaktuara me këtë Rregullore.

30.2 Ekipi ka të drejtë regjistrimi të lojtarit ndërkombëtar(të Huaj). Kërkesën për regjistrim me dokumentacionin komplet duhet t`a dorëzojë në FBK më së voni 48 orë para filimit të ndeshjes kampionale apo të Kupës.

30.3 Numri i paraqitjeve të lojtarëve ndërkombëtar për të gjitha ligat dhe angazhimi I tyre në një ndeshje përcaktohet me Propozicione të Garave.

30.4 Lojtari I huaj mund të realizojë vetëm një (1) kalim prej ekipi në një ekip tjetër vendor gjatë afatit kalimtar (ne te njejin rrang garash) kurse , (deri ne afatin i cili përcaktohet sipas Propozicioneve te Garave ne rangun më te ulët garash.



30.5. Lojtari ndërkombëtar gjer në moshën 18 vjeçare I cili ka vendbanim në Republikën e Kosovës në bazë të shkollimit apo punës së përkohëshme, mund të regjistrohet si lojtar vendor dhe të paraqitet për grupmosha të reja, me leje të Komesarit të Garave (Komisionit për regjistrim).

Neni 31.

31.1 Lojtari I huaj I cili paraqitet për të luajtur në ndonjë ekip në Republikën e Kosovës dhe gjatë kampionatit aktual fiton të drejtën për paraqitje në përzgjedhjen e Kosovës, fiton të drejtën që për ekip të regjistrohet si lojtar vendor, nëse regjistrohet para fillimit të pjesës së dytë të kampionatit.

31.2 Për regjistrim të çdo lojtari ndërkombëtar ekipi është I obliguar të paguaj taksën për regjistrim në FBK dhe FIBA, e cila përcaktohet me Propozicionet e Garave.

X. PARQITJA E LOJTARËVE

Neni 32

Në ndeshjet e të gjitha ligave si dhe ndeshjet për Kupë, lojtarët mund të paraqiten vetëm nëse posedojnë licencë e lëshuar nga Komesari I Garave i FBK-së

LICENCA E DYFISHTË

Neni 33.

33.1 Lojtarët gjer në moshën 20 vjeçare (Viti lindjes 2000 e me i ri) , I cili ka të drejtë paraqitjeje në superligën gjegjësisht në ligën e parë te seniorëve FBK-së,mund të paraqitet për ekip tjetër në nivel më të ulët të garave, me lëshimin e licencës se dyfisht, në bazë të pëlqimit me shkrim të ekipit për të cilin është I regjistruar lojtari.

Nëse ekipi I cili e jep pëlqimin për licencim të dyfisht I ka ekipet e reja, të gjithë lojtarët të cilët kanë të drejtë paraqitjeje për këtë ekip në ligat për të rinjë, pa marr parasysh se a gjinden në listen e seniorëve, mund të paraqiten me licencë të dyfisht për ekipin tjetër të seniorëve në nivel më të ultë.

33.2 Një ekip mund të ketë më së shumti tre(3) lojtarë me licencë të dyfisht gjatë njëedicioni garues.

33.3 Licenca e dyfisht mund të lëshohet 24 orë para fillimit të pjesës së parë apo të dytë të kampionatit.

33.4 Lojtari me licence të dyfisht nuk mund të paraqitet për të luajtur për dy ekipe në ditën e njejt të zhvillimit të ndeshjeve.

33.5 Lojtarët gjerë në moshën U18 dhe U16 në të dy konkurrencat (meshkuj-femra) të cilët kanë të drejtë të paraqiten në kategoritë e reja te klubet e tyre- te klubet seniore ,mund të regjistrohen me licencë të dyfishtë dhe të paraqiten në ekipet seniore – kategori të reja për një edicion.

Licencimi duhet të bëhet në afat kalimtar ose deri 24 orë para fillimit të pjesës së parë apo të dytë të kampionatit.

Lojtari me licence të dyfishtë nuk mund të paraqitet për të luajtur për dy ekipe në ditën e njejtë të zhvillimit të ndeshjeve.

Ky licencim është i mundur vetëm për lojtarët e licencuar në shkolla të basketbollit-klube të cilët nuk i posedojnë të gjitha kategoritë e reja – kategorinë seniore.

Neni 34.

34.1 Lojtari mund të paraqitet për ekip tjetër për ndeshje miqsore apo ndeshje zyrtare ndërkombëtare, vetëm me pëlqimin e ekipit për të cilin është i regjistruar lojtari për edicionin garues.

34.2 Në rast të shkeljes së dispozitës 37.1, lojtari dhe ekipi për të cilën paraqitet, bëjnë shkelje disiplinore.



XI.REGJISTRIMI DHE LICENCIMI I TRAJNERËVE

Neni 35

- 35.1 Regjistrimin e trajnerëve të basketbollit e bënë Komesari I Garave i FBK-së.
- 35.2 Trajnerët e basketbollit mund t`a kryejnë detyrën e tyre nëse posedojnë licence e trajnerëve.
- 35.3. Licencën për kryerjen e detyrës së trajnerit e lëshon Shoqata e trajnerëve, në bazë të kriteriumeve
- 35.4 Marrëveshjet për rregullimin e të drejtave dhe obligimeve reciproke në mes të trajnerit dhe ekipit evidentohet në FBK.
- 35.5 Marrëveshjet për rregullimin e të drejtave dhe obligimeve reciproke në mes të trajnerit dhe ekipit, të cilat nuk janë evidentuar në FBK nuk kanë asnjë veprim ligjor.
- 35.6. Marrëveshja për rregullimin e të drejtave dhe obligimeve duhet në mënyrë detale të përshkruaj të drejtat dhe obligimet e tranerit dhe ekipit. Trajneri ka të drejtë, nëse nuk I plotësohen kërkesat financiare sipas marrëveshjes, të kërkojë mbrojtjen e ligjshmërisë dhe Komesari I Garave nuk mund t`I lëshojë ekipit licence për trajner të ri, deri sa ekipi nuk dëshmon se I ka përmbush obligimet t financiare. Trajneri ka të drejtë të tërhiqet nga pretendimet e perealizuara dhe me njoftim në formë shkrimi të njoftojë FBK-së.
- 35.7 Për kryerjen e detyrës së trajnerit, ekipi është I obliguar të paguajë taksën në shumën e caktuar me vendim të posaçëm të Bordit të FBK-së

XI.REGJISTRIMI DHE LICENCIMI I TRAJNERËVE

Neni 36

- 36.1 Kundër aktvendimit të Kmesarit të Garave(Komisionit për regjistrim) të FBK-së, të publikuar në faqen zyrtare të FBK-së, dhe kundër të gjitha vendimeve të tij, palët në afat prej 3 ditësh nga dita e publikimit apo nga dita e pranimit të vendimit, kanë të drejtë ankesenërmjet të Komesarit të Garave (komisionit regjistruar) Komisionit Arbitrar të FBK-së.
- 36.2 Ankesa e cila është dorëzuar pas afatit të caktuar për ankesë do të refuzohet dhe nuk do të shqyrtohet.
- 36.3 Nëse kundër vendimit të Komesari të Garave (Komisionit për egjistrim) të FBK-së, një nga palët ka paraqit ankesë, regjistrimi dhe paraqitja e lojtarit nuk është I lejuar gjer në vendimin e marru nga Komisioni Arbitrar i FBK-së.
- 36.4 Komisioni Arbitrar është I obliguar që në afat prej shtatë(7) ditësh të marri ankesën në shqyrtim.
- 36.5 Kundër vendimit të plotëfuqishëm të Komesarit të Garave (Komisionit për regjistrim), palët kanë të drejtë të kërkojnë mbrojtjen e ligjshmërisë e cila dorëzohet nëpërmjet të Komesarit të Garave (komisionit për regjistrim) Bordit të FBK-së.
- 36.6 Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk ka efekt pezullues ne vendimin e plotëfuqishëm të Komesari të Garave (Komisionit për regjistrim), dhe vendimi I marrur sipas kërkesës nuk ka efekt retroaktiv në lidhje me ndeshjet të cilat janë zhvilluar gjer në marrjen e saj.
- 36.7 FBK nuk merr përgjigjësi për kurfarë kompenzimi të dëmeve të shkaktuara për anulimin e vendimit të shkallës së pare.
- 36.8 Nëse palët nuk kanë shfrytëzuar të drejtën e ankesës, të njejtit u kanë të drejtë të paraqesin kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër vendimit të Komesarit të Garave(Komisionit për regjistrim) të FBK-së.



XIII. DORËZIMI

Neni 37.

37.1 Korespondencën me FBK dhe komisionet e FBK-së palët e kryejnë nërmjet të zyrës së FBK-së.

37.2 Dorëzimi i shkresave në FBK kryhet drejtëpërdrejtë në zyrën e FBK-së, me anë të postës dhe me anë të postës elektronike.

37.3 Çdo shkresë e dorëzuar nga personi juridik në FBK duhet të jetë e nënshkruar dhe vulosur nga personi i autorizuar, apo të nëpërmjet të autorizuesit me autorizimin e bërë nga noteri.

37.4 Çdo shkresë e dorëzuar nga personi fizik në FBK, duhet të dorëzohet në mënyrë fizike duke bashkangjitur dokumentin për identifikim personal, apo të nëpërmjet të autorizuesit me autorizimin e bërë nga noteri.

37.5 Data e pranimit të shkresës konsiderohet dita kur shkresa është dorëzuar drejtëpërdrejtë, postës dhe postës elektronike.

37.6 Zyrja- administrate e FBK-së shkresat e dorëzuara i adresojnë në palët e cekura në adresë.

XIV. AFATET

Neni 38.

38.1 Afate nënkuptohen ditët, muajt dhe vitet.

38.2 Nëse afatet janë caktuar me ditë, në afat nuk llogaritet dita e dorëzimit të shkresës.

38.3 Brenda afatit të përcaktuar, do të konsiderohet dita e parë e ardhëshme.

38.4. Në afat të përcaktuar nuk llogaritet dita e diel dhe festat shtetërore, dhe afati kalon pas kalimit të ditës së parë të ardhshme punuese.

XV. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE KALUESE

Neni 39.

Të gjitha çështjet tjera të cilat nuk janë paraparë me këtë rregullore dhe Rregullat zyrtare të basketbollit, do të përcaktohen me Propozicionet e garave, aktet normative të FBK-së dhe FIBA.

Neni 40.

Ndërrimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje miratohen sipas procedurës së njejtë të aprovimit të tyre.

Neni 41.

Interpretimin e kësaj Rregulloreje e jep Bordi i FBK-së, në mënyrë direkte apo nëpërmjet të Komisioneve të tij.

Neni 42.

Kjo Rregullore hynë në fuqi me miratimin e saj nga ana e Bordit të FBK-së .

Kryetari i FBK-së

EROLL D BELEGU